



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:300378

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06736946

**C.nr.1035/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. B. nga fsh. M. K. L., të cilin e përfaqëson Shpetim Sadiku av. nga Lipjani me autorizim, ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, për shkak të kompensimit të ardhurave personale, jashtë seance gjyqësore, me dt.21.01.2025 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditëses V. B. nga fsh. M.K. L. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit– Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj në emër të shpërblimit Jubilar për 10 vite të përvojës së punës 50% të pagës bazë shumë prej **210.50-€**, në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt.22.04.2022-20.11.2022 për 35 ditë pune shumë prej **70-€**, në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt.23.04.2022-21.11.2022 për 46 ditë pune shumë prej **92-€** si dhe në emër të kualifikimit diferencën shtesë në pagë prej 35% në pagën bazë për periudhën nga dt.28.12.2020-04.02.2023 në shumë prej **2,314.78-€**, të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.28.12.2023 e deri në përmbushjen definitive si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 238.00-€ në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja, përmes të autorizuarit në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim për shujten ditore dhe kompensimin në emër të kualifikimit. Në padi ka theksuar se paditësja është mësimdhënëse në SHFMU ”H. B.” në fsh. M. K. L. dhe e njëjta i plotëson kushtet e përfitimit të pagës jubilarë, shujtes ditore dhe kompensimit në emër të kualifikimit sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

I autorizuari i paditëses përmes parashtrësës së datës 14.11.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë më konkretish si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në të përgjigjur në padi e paditura e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe ka shtuar se sipas nenit 90 pika 5 te Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësja, thuhet

se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj Marrëveshje-Kontratës Kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Ndërsa sa i përket kualifikimit ka shtuar se vendimi i QRK-së nr.03/33 nuk parasheh asnjë obligim për Komuna. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata pasi vlerësoj padinë e paditëses dhe poashtu pasi vlerësoi përgjigjen në padi dhe konstatoi nga provat e bashkangjitura në padi (nga kontrata e punës nr.04-112-813/4253 e dt.01.09.2023 në SHFMU "H. B." në fsh. M. K.L., Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.1/22 e dt.17.01.2019, e lëshuar nga SHMP "A. G." në L., Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.125/1 e dt.18.01.2019, e lëshuar nga SHFMU "V. D." në fsh. T. K. L., Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.116/23 e dt.14.12.2023, e lëshuar nga SHFMU "V. D." në fsh. T. K. L., Vërtetim për ditet e pranisë në punë nr.115/23 e dt.14.12.2023 e lëshuar nga SHFMU "V. D." në fsh. T. K. L., Vërtetim për ditet e pranisë në punë e dt.14.12.2023 e lëshuar nga SHFMU "H. B." në fsh. M. K.L., Diploma master e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "H. P." me nr.1161 e dt.18.03.2022, lista e pagave), se e paditura për kundër kontestimit të bazës juridike të padisë i ka pohuar faktet vendimtare në këtë çështje kontestimore, pra faktet se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, mësimdhënëse në SHFMU "H. B." në fsh. M. K. L. dhe për periudhën kontestuse e njëjta ka gjithësej 46 ditë pune dhe SHFMU "V. D." në fsh. T. K. L. ka gjithësej 35 ditë pune dhe për periudhën konestuse ka punuar me Diplomë universitare master ku i takon kompenzimi shtesë në pagën bazë prej 35 %, andaj gjykata konform nenit 152 të LPK-së e aprovoi kërkesëpadinë e precizuar të paditëses pasi që nuk ka pengesa tjera ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë është vërtetuar në provat që u përmenden më lart dhe në bazë të nenit 35 par. 8 të Kontratës kolektive të Arsimit Parauniversitar të dates 18.04.2017, parashihet se *"Punëtorët (antarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënsi i fundit dhe atë prej 50 % të një page bazë për 10 vjet të përvojës së punës", 75 % të një page bazë për 20 vjet të përvojës së punës", 100 % të një page bazë për 30 vjet të përvojës së punës", 150 % të një page bazë për 40 vjet të përvojës së punës", në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.105 të dt.22.01.2021, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjësit arsimor kompensohen për shpenzimet e ushqimit me nga 2 euro për një ditë pune. Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë është vërtetuar në provat që u përmenden më lart dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë 01/33 dt.29.03.2008 është paraparë rritja në emër të kualifikimit prej 35% të pagës bazë me kualifikim master.*

Poashtu me nenin 8 të LMD-së, ku thuhet se *"Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit"*, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditëses.

Pra, mbi gjendjen faktike që u përmend më lart dhe dispozitat materiale të lartë përmendura paditëses i takon shtesa në pagë në emër të pagës jubilarë për 10 vite të përvojës së punës pra të 50% të një page bazë, shujtës ditore për ditët e pranisë në punë për periudhën

kontestuese si dhe kompenzimi në emër të kualifikimit pasi e njëjta gjatë periudhës kontestuese ka punuar me Diplomë Universitare me titull Master ku i takon shtesa në pagë prej 35 % të pagës bazë dhe se e paditura ka për detyrë t'ia kompensoj këto shtesa sepse është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimit andaj gjykata e detyroj të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shtesat për pagë jubilarë, ushqim dhe kompenzim në emër të kualifikimit.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoj kundërshtimet e të paditurës mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pa bazuara me arsyetimin se KKA e vitit 2021 që është zbatueshme në rastin konkret është e detyrueshme për të paditurën dhe në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”. Gjithashtu e detyrueshme për të paditurën është edhe kompensimi në emër të kualifikimit pasi që Vendimi i Qeverisë i lartpërmendur është detyrues dhe të njëjtën pjesërisht e ka zbatuar mirëpo me rritjen e pagës bazë nuk është rritur pjesa e kualifikimit.

Vendimi për kamatën u bazua në nenin 382 par.2 të LMD-së, ku është llogaritur kamata prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri tek pagesa definitive nga arsyet se kemi të bëjmë me dëm material e që duhet të llogaritur nga paraqitja e kërkesës kjo edhe në pajtim me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata konform nenit 452 dhe 453 të LPK-së e detyroj të paditurën që palës paditësi tia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë shumën prej 104 euro për përpilimin e padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkespadisë shumën prej 104 të llogaritura me vlerë të kontestit të vogël deri në 10,000.00 euro si dhe shumën prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore, apo shumën e përgjithshme prej 238-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për qka edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lart dhe dispozitave të lartpërmendura u vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**  
**C.nr.1035/2023 me datën 21.01.2025**

**Gj y q t a r i**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:300378  
Datë: 21.01.2025  
Numri i dokumentit: 06736946